

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

949.65.071.

N13

STAVRI N. NAÇI

**PASHALLËKU
I SHKODRËS**

(1796 - 1831)

94 P.65


N13

AKADEMIA E SHKENCAVE TË RPS TË SHQIPËRISË

INSTITUTI I HISTORISË

Stavri N. Naçi

PASHALLËKU I SHKODRËS
NË VITET E PARA TË
SHEK. XIX (1796-1831)



TIRANË, 1986

tij, në vitin 1831, për të cilën është bërë fjalë më gjerë. Mirëpo kjo literaturë, pavarësisht nga vlera shkencore e saj, nuk zbulon veçse një pjesë të vogël, ose më saktë, vetëm pak vite të zhvillimit politik tri-dhjetë e pesë vjeçar të Pashallëkut të Shkodrës.

Vetëkuptohet se këto të dhëna bibliografike, që në përgjithësi jepen në formë të përmbledhur, si dhe të dhënat e pakta të nxjerra nga burime arkivore vendase dhe të huaja, që disponoheshin 20 vjet më parë, nuk ishin të mjaftueshme për të ndër marrë studimin e periudhës 1796-1831 të Pashallëkut të Shkodrës. Për një studim të tillë duheshin siguruar shumë të dhëna sepse, pjesa më e madhe e periudhës mbetej e zbrazët.

Nën kujdesin e Drejtorisë së Institutit të Historisë dhe pastaj të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, ekiye studiuesish e specialistësh si dhe autori kryen për disa vjet me radhë kërkime nëpër arkiva të ndryshme. Kështu u bë i mundshëm grumbullimi i një materiali mjaft të pasur, ndonëse ende jo krejtësisht të plotë, që u bë baza mbi të cilën u mbështet studimi ynë.

Meqenëse ndihmesa e bibliografisë historike ka qenë e pakët, po paraqesim në mënyrë të përmbledhur çka përfaqëson kjo ndihmesë bibliografike për monografinë tonë. E ndiejmë për detyrë të pohojmë se grupi i autorëve turq Ahmet Xhevdet pasha, Shanizade Mehmet Ataullah dhe sidomos Ahmet Lytfi¹, të mbështetur në të dhënat dokumentare arkivore osmane, kanë qenë një burim mjaft i dobishëm. Megjithëse bëjnë fjalë për historinë e Perandorisë Osmane, shkarazi ata kanë trajtuar edhe ngjarjet në Shqipëri si pjesë përbërëse e asaj perandorie, duke vënë në dukje sidomos pjesëmarrjen e pashallarëve shqiptarë në ngjarjet me karakter politik të Rumelisë, e veçanërisht kundër kryengritjeve nacionalçlirimtare të popujve serb e grek.

Një burim të tillë përbëjnë edhe trajtesat e autorëve serbë N. Gavrilović dhe D.M. Pavlović² mbi pjesëmarrjen e Mustafa pashë Bushatllit në luftën ruso-turke të viteve 1828-1829 dhe mbi kryengritjen e vitit 1831 në Shqipërinë Veriore.

Një pjesë e të dhënave faktike të dy grupeve të autorëve të lartpërmendur kanë vlejtur në disa raste si mbështetje ku s'ka patur njoftime të tjera, por vetëm kur jemi bindur për vërtetësinë e këtyre lloj të dhënave, sepse edhe te këta autorë ka pasaktësira faktike, të cilat ose janë lënë në heshtje, ose është bërë vërejtja e duhur. Por, si historianë të huaj, të dy palët i kanë trajtuar ngjarjet dhe i kanë interpretuar ato nën prizmin e interesave politike të shteteve të tyre. Historianët turq, të nisur nga fakti se Shqipëria ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane dhe se qeveritarët e saj ishin funksionarë të lartë të kësaj perandorie, i kanë trajtuar ata si të tillë, si shtetas osmanë të detyruar të merrnin pjesë në ato ngjarje që i përkis-

1) Ahmet Cevdet pasa — *Tarihi*, (ikinci basem), Istanbul, 1309, H.; Ahmet Lutfi — *Tarihi*, Istanbul, 1290-1292). Shanizade Mehmet Ataullah efendi — *Tarihi*, Istanbul, 1868.

2) Gavrilović, M. Milosh Obrenović, Beograd 1912; Pavlović, D. M. Pokret u Bosni i u Albaniji, Beograd, 1913.

nin shtetit osman. Përveç kësaj, duke mos mundur të dallojnë ç'fshihet prapa disa deklaratave të qeveritarëve në fjalë, ata paraqiten fare qartë si historianë objektivistë, aq më shumbë se nuk janë përpjekur të gjejnë e të paraqesin as shkaqet e vërteta të pjesëmarrjes së vezirëve apo pashallarëve shqiptarë në ngjarjet. Edhe kryengritjes së vitit 1831, ata i japin karakterin e një grindjeje të brendshme në perandori apo të një rebelimi të zakonshëm ndaj qeverisë qendrore³, duke paraqitur si shkak për këto grindje arsye subjektivistë si ambicjen, karrierizmin, etj. dhe nuk bëjnë fjalë fare se Bushatlliu, pashallarët kosovarë e Iljaz Poda, që e pasuan atë ishin shqiptarë, vepronin në truallin amtar dhe u hodhën në kryengritje kundër pushtetit qendror e reformave centralizuese të tij të përkrahur nga shtresat e ndryshme të shoqërisë shqiptare, të cilat i quanin ato si një dhunë të papranueshme, si shkelje të të gjitha fitoreve të arritura me luftën shekullore antiturke, si një pushtim të dytë që i bëhej vendit dhe kombësisë së tyre.

Nga ana e tyre, historianët serbë, të cilët kanë qenë dy nga përfaqësuesit e shovinizmit serbomadh, i afrohen qëndrimit të historianeve turq duke i quajtur ngjarjet politike në Shqipëri në vitet 20 të shek. XIX si shfaqje të anarkisë feudale osmane në provincën fqinje të tyre. Sidomos D.M. Pavloviçi, kur trajton kryengritjen e vitit 1831 të Shqipërisë Veriore, nga njëra anë e quan atë si lëvizje antireformiste, kurse nga ana tjetër, duke bërë krahasim me atë të Bosnjës ia zvogëlon rëndësinë, gjë që e hédh poshtë dokumentacioni osman. Sipas vlerësimit të vetë sulltanit, dhe siç e treguan edhe faktet, lëvizja në Shqipëri për Portën e Lartë ishte shumë më e rëndësishme dhe rrezikonte copëtimin e Perandorisë. Sipas një vlerësimi të tillë forcat ushtarake osmane u përqendruan në Shqipëri dhe, pas likuidimit të qëndresës aty, Veziri i Madh u mor me Bosnjën. Për më tepër, Pavloviçi i fryn artificialisht synimet e kapidan Hysen Gradashçeviçit sikur ky donte të çlironte Bosnjën kurse në të vërtetë kishte për qëllim të bëhej Vali i Bosnjës dhe nënvleftëson synimet e Mustafa Pashës duke pohuar se ky nuk kishte për synim «ta bëjë atdheun e tij të lirë», dhe se mbronte interesat vetjake. Për rrjedhim kryengritjen e vitit 1831 e quan «Kryengritja e Mustafait»⁴ në kuptimin personal.

Ndryshe nga dy grupet e lartpërmendura, grupi i autorëve francezë si Siprien Rober e Hiasintë Hekar, të cilët me sa duket janë mbështetur kryesisht në të dhënat e shtypit të kohës dhe në gojëdhënat e mëvonshme, sepse nuk japin referime për burimet ku janë mbështetur, shumë pak, për të mos thënë aspak, e kanë ndihmuar punimin. Shkrimet e tyre karakterizohen nga pasaktësira, kurse sllavofili i zellshëm S. Rober i fryn gjërat kur thotë se në vitet 1828-1829, Mustafa Pasha pretendonte për të zënë fronin e sulltanit.

Historiografia shqiptare e paraçlirimit ka dhënë një ndihmesë për pasurimin e ngjarjeve politike në Shqipërinë e Veriut, veçanërisht lidhur me grindjet për pushtet pas vdekjes së Ibrahim Pashës dhe

3) Ahmet Lytfti, *Tarihi*, f. 180.

4) D. M. Pavloviç, vep, e përm, kreu X.

për ardhjen në fuqi të Mustafa Pashës. Këtë ndihmesë e konfirmojnë, por edhe e plotësojnë dhe e përsaktësojnë, burimet dokumentare. Kurse historiografia jonë e pasqirimit, me përjashtim të ndonjë të dhëne arkivore nuk është marrë me studimin e mirëfilltë të periudhës 1796-1831⁵.

Prandaj punimi është mbështetur kryesisht në të dhënat dokumentare të nxjerra prej një vargu arkivash të brendshme dhe të jashtme të pashfrytëzuara nga autorë të tjerë. Prej tyre, më të pasurat e më të rëndësishmet janë arkivat e Ministrisë së Jashtme të Francës dhe ato të Kryeministrisë së Turqisë.

Të dhënat arkivore franceze, që janë nxjerrë në mikrofilma nga fondet «Korrespondencë tregtare konsullore» dhe «Korrespondencë politike konsullore» e arkivave të Ministrisë së Jashtme të Francës në Paris⁶, fillojnë që nga vitet e fundit të shekullit XVIII dhe kanë për burim përfaqësinë franceze në Raguzë. Veçse këto janë shumë të pakta. Ato dendësohen sidomos nga viti 1806, kur si në Janinë, ashtu dhe në Shkodër çelen përfaqësitë konsullore të Perandorisë Franceze. Këtyre të dhënave u shtohen nga viti 1807 edhe ato të diplomatëve francezë drejtuar Ministrisë së Jashtme nga Korfuzi e Venediku deri më 1814, kur forcat ushtarake franceze u larguan nga zotërimet në Ishujt Jonianë dhe në Dalmaci. Por nga viti 1822 e deri në vitin 1831 të dhënat franceze mbi ngjarjet në Shqipëri, edhe pse të rralla, rifillojnë duke pasur për burime kryesisht përfaqësitë diplomatike mbretërore në Korfuz dhe në Selanik. Nuk duhet harruar se për periudhën në studim janë nxjerrë të dhëna edhe nga përfaqësia diplomatike e qeverisë franceze në Stamboll.

Vetëkuptohet se korrespondenca e konsullit francez nga Shkodra është më e rëndësishmja jo vetëm për nga sasia, por edhe për nga vërtetësia historike. E shkruar nga konsulli Mark Bryerë, i cili njihete gjuhët osmane, italiane e sllave, sepse ishte rritur në Raguzë dhe banoi në Shkodër rreth tetë vjet, ajo përbën një burim me vlerë. Për historinë e Pashallëkut të Shkodrës ky konsull meriton të zerë po atë vend të rëndësishëm që ka Fransua Pukëvilë për historinë e Pashallëkut të Janinës në vitet 1806-1814 me ndryshimin se Mark Bryeri, edhe pse ka lënë një trashëgim dëshmish më të kufizuara, ka meritën se ka pasqyruar shumë më me vërtetësi ngjarjet, personalitetet dhe opinionin e kohës mbasi, sipas mendimit tonë, ai nuk e ka pasur aq të zhvilluar prirjen për të intriguar dhe nuk ka pasur urrejtjen e shfrenuar të Fransua Pukëvilit ndaj shqiptarëve. Madje për shkak se i pasqyronte dhe i interpretonte drejt veprimet, duke mos i parë ato gjithmonë nga pozitativat e shtetit borgjez agresor francez, atij iu lërhoq vërejtja e rëndë nga vetë perandori diktator i francezëve, Napoleoni I. Kjo solli si pasojë që në shkrimet e tij të ketë edhe mjaft dobësi. Megjithatë, dë-

5) Historia e Shqipërisë. Tiranë, 1959, f. 453-454, 467-469, 474, 480-482, 484-486; Ligor K. Mila. Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes sonë. (1830-1878). Tiranë, 1962, f. 59-60, 69-76.

6) Archives du Ministère des Affaires Etrangères de France. Correspondance Commerciale Consulaire et Correspondance Politique Consulaire (Më tej AMAE — CCC ose CPC).

shmitë e Mark Bryerit janë një nga burimet më të vlefshme për njohjen e historisë politike të Pashallëkut të Shkodrës në tri vitet e fundit të qeverisjes së Ibrahim pashë Bushatlliut, për të cilin kishim dijeni shumë të pakta, si dhe për pesë vitet e para të veprimtarisë së Mustafa Pashës, për ardhjen në fuqi të të cilit gjithashtu kishim të dhëna të varfra e mjaft të paqarta.

Përveç kësaj, ky konsull nuk ka lënë pa prekur edhe zhvillimin ekonomik e sidomos tregtar të Shkodrës, megjithëse për gjendjen e fshatit është tepër i kufizuar, gjë që përbën anën më të dobët të korrespondencës së tij. Kjo korrespondencë në pjesën dërrmuese të saj u është drejtuar ministrave të jashtëm të Francës: Talerjan, Dë Shampanjë dhe dukës së Kagorës, nga të cilët, sado rrallë, ka udhëzime të nisura nga kryeqyteti francez ose qytetet e ndryshëm ku shkonte një pjesë e qeverisë së Napolonit gjatë fushatave luftarake të tij nëpër Evropë. Ka edhe letra të shkëmbyera midis Mark Bryerit dhe Pukëvilit ose autoriteteve franceze në Ishujt Jonianë e Dalmaci, që flasin sidomos për marrëdhëniet midis vezirëve Bushatllinj dhe Ali pashë Tepelenës.

Pas vitit 1814, për arsyet që u thanë më lart, burimet dokumentare franceze ndërpriten. Vendin e tyre e zënë burimet austriake, angleze etj. dhe sidomos ato osmane.

Të dhënat arkivore osmane, e veçanërisht ato të mikrofilmuara nga fondi «Vendime perandorake» të arkivit të Kryeministrit⁷, janë në radhë të parë letra të funksionarëve të mëdhenj osmanë, duke përfshirë këtu edhe letrat e vezirëve shqiptarë drejtuar Portës së Lartë, si dhe letra të vezirit të madh e kryesisht të kajmekam pashës që ia përcillte ato sulltanit duke shprehur mendimin e Divanit si mendimin e vet për ngjarjet e ndryshme në Shqipëri, në Bosnjë, në Greqi, etj. Kjo korrespondencë ka, përveç këtyre mendimeve, edhe pikëpamjet apo vendimet përkatëse të vetë sulltan Mahmudit II. Vetëkuptohet se këto të dhëna janë të një rëndësie të veçantë dhe të pazëvendësueshme në krahasim me të dhënat e burimeve të tjera, mbasi aty pasqyrohen planet e vendimet më të larta dhe të prera, të hapura ose të fshehta, të udhëheqjes së shtetit osman. Pikërisht kjo bazë burimore ka shërbyer për të mbajtur qëndrim lidhur me shumë ngjarje politike e ushtarake, që autorë të tjerë i kanë paraqitur duke u mbështetur në burime më pak të sigurta.

Rëndësia e veçantë e të dhënave arkivore osmane qëndron edhe në faktin se ku më shumë e ku më pak ato janë shpërndarë gjatë gjithë periudhës në studim. Në vitet kur mbështetjen kryesore e përbëjnë burimet e tjera, dokumentacioni osman luan rol plotësues, kurse në vitet kur këto burime rrallohen ose heshtin ai luan rol më të rëndësishëm. Kjo vërehet për vitin 1814 dhe sidomos për vitet 20.

Por, megjithë anët e mira, materiali dokumentar osman ka një varg dobësish. Një pjesë e mirë e tij, pikërisht korrespondenca midis kajmekam pashës dhe sulltanit, të cilit shpesh i paraqiste përmbledhjet e letrave të ardhura në Portën e Lartë, nuk përmbajnë data. Përveç kësaj, ka dokumente që nuk mbajnë numrin që individualizon çdo dokument në fondin ku bën pjesë. Këtë mungesë e kemi pasqyruar në

7) Basbakanlik Arsivi, Istanbul — Hattihumayun defterleri (më tej BAIHD).

shënimet duke dhënë si referim shenjat kryesore të dokumentit sikurse janë autori dhe data, mbasi nuk kemi pasur mundësi tjetër për ta mënjeluar këtë të metë teknike që duket se e ka burimin qysh kur është bërë mikrofilmi. Por më me rëndësi është fakti se dokumentacioni osman që kemi nuk ka vazhdimësi jo vetëm në kohë, por edhe në ngjarje, prandaj është në përgjithësi material ngjarjesh të shkëputura. Gjithashtu, jo gjithmonë brendia e dokumenteve i paraqet ngjarjet me vërtetësinë e plotë të tyre, sidomos për arsye subjektive. Funkcionarët osmanë ose i fryjnë sukseset e tyre, ose nuk i përmendin disfatat. Një shembull i tillë është ai i thyerjes së Mehmet Reshid pashës më 21 prill 1831, në derbendin e Perlepit nga forcat e Mustafa Pashës së Shkodrës.

Sidoqoftë, duke e parë këtë dokumentacion me syrin kritik dhe duke e përdorur me kujdes, ai ka shërbyer si një bazë materiale e kënaqshme, pa të cilën një varg problemesh nuk do të kishin dalë në dritë ose do të mbeteshin të pasqaruara.

Tjetër burim të dhënash, sidomos për vitet 20 të shek. XIX, janë dokumentet e Arkivit shtetëror në Zara nga fondi «Akte të kryesisë»⁸, të shkruara nga zëvendëskonsulli austriak në Shkodër G.P. Balarin, si dhe nga komandanti i policisë së rrethit të Kotorrit. Të dhënat e këtyre akteve, të nisura nga kryeqyteti i Pashallëkut të Shkodrës ose nga krahina austriake në afërsi të kufirit të tij, edhe pse përbëjnë një sasi të vogël në krahasim me ato francezet e osmanet, janë në të njëjtën kohë dëshmi me interes dhe ngandonjëherë të vetme për ngjarjet e këtyre viteve sikurse ekspedita e ushtrisë së Vezirit të Shkodrës në Akarnani më 1823, marrëdhëniet me malazeztë e boshnjakët, marrëdhëniet me pashallarët kosovarë, pjesëmarrja në frontin e Vidinit më 1829.

Edhe këto të dhëna për punimin tonë luajtën rol të dorës së parë, sepse kryesisht ato e çanë errësirën që mbulonte zhvillimin politik në Shqipërinë Veriore për vitet 20 të shek. XIX.

Megjithëse të pakta, të rëndësishme janë edhe materialet e arkivave të tjera të huaja⁹, sepse në disa raste këto kanë plotësuar mungesat e të dhënave të arkivave të lartpërmendura.

Në saje të këtij materiali bashkëkohës të pasur ky studim, së bashku, me monografinë tonë për vitet 1757 — 1796 të Pashallëkut të Shqipërisë së Veriut, arrin në përfundimin se ky pashallëk ashtu si dhe ai i Shqipërisë të Jugut (për të cilin jemi duke përfunduar një studim monografik të veçantë) jo vetëm nuk ishin produkte apo fenomene «anarkie» dhe «shturjeje e degjenerimi», sikurse pohojnë disa autorë të huaj¹⁰, por përkundrazi ishin pasojë objektive e zhvillimit të brend-

8) Drzavni Arhiv, Zadar — Presidialni Spisi (më tej DAZ, PS.)

9) Haus Hof und Staats, Archiv, Wien — Politiches Archiv Turkei (më tej HHStA, PA, T); Foreign Office, London — Public Record Office (më tej FO-PR); Archv Vneshnjej politiki Rossii (më tej AVPR).

10) Stadmuller, G., *Geschichte Sudosteuropas*, Munchen, 1950, f. 345-347; Vu-kosavljević, S.D., *Istoria seljackog drustva*, Beograd, 1957, f. 12-13; Djordjević, D., *Les révolutions nationales des peuples balkaniques 1804-1914*, Beograd, 1965, f. 221-222; Sokollova, B., *Mjakoi bprosi na Albanaskata literatura prez XVIII v. in «Studia Balcanica»*, Sofia, 1977, nr. 13, f. 99.

shëm ekonomik e shoqëror të vendit, të cilët u bënë faktorë me rëndësi të dorës së parë, sepse, duke bashkuar e qeverisur në mënyrë efektive autonome shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare, krijuan kushte të përshtatshme për një zhvillim ekonomik e politik me ritme të shpejta të kësaj popullsie. Me dy tregjet ndërkrahinore, të formuara gjatë shekullit XVIII e të përforcuara gjatë gjysmës së dytë të tij kur u formuan edhe dy formacionet politike paralele të lartpërmendura, u bënë dy hapa shumë të rëndësishëm përpara: i pari, drejt formimit të një tregu të vetëm kombëtar, i dyti, drejt bashkimit politik të gjithë vendit. Pra, ka qenë «një proces me elemente ekonomike e politike që çonin përpara» proces që ishte «shprehje e një qëndrese të përgjithshme të një kombësie të nënshtruar, në të cilën, bënte pjesë edhe klasa feudale e fuqizuar shqiptare»¹¹, e cila, në rrethana të caktuara politike nuk nguroi të hynte në luftë kundër pushtetit qendror osman me synim shpëtimor nga varësia politike e tij dhe për krijimin e shtetit shqiptar autonom ose të pavarur, siç detyrohet të pohojë në bazë të dokumenteve kokëfortë dhe ndonjë autor i huaj, i cili, për çështje të tjera të mëvonshme të historisë sonë politike, shkon në gjurmët e historianëve të huaj të përmendur më sipër¹².

*
* *
*

Pas diskutimeve në Sektorin e Historisë së Mesjetës dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Historisë, kjo monografi u miratua për botim në muajin qershor 1981. Së fundi, ajo u diskutua dhe u mbrojt me sukses si disertacion i shkallës së dytë të kualifikimit pasuniversitar në Seksionin e Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave të RPSSH më 16 janar 1984. Vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë shërbyen për përmirësimin e plotësimin e studimit. Me rastin e botimit të tij e ndiej për detyrë të falënderoj me mirënjohje të përzemërt kolegët e mij të sektorit e në mënyrë të veçantë recensentët e oponentët, shokët Aleks Buda, Ligor Mile, Petrika Thëngjilli, Selami Pulaha e Zija Shkodra.

1) Buda, A., *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike*, në: «Studime historike», Tiranë, 1978, nr. 3, f. 50-51.

12) Stojancevic, V., *Jugoslovenski narodi u osmanskom carstvu od Jedrenskog mira 1829 do Pariskog kongresa 1856 godine*, Beograd, 1871, f. 49, 62.

K R E U I

VËSHTRIM MBI ZHVILLIMIN EKONOMIKO-SHOQËROR DHE POLITIK TË PASHALLËKUT TË SHKODRËS NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XVIII

1. DUKURITË KRYESORE TË GJENDJES EKONOMIKO-SHOQËRORE TË SHQIPËRISË VERIORE

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe në tridhjet vitet e para të shekullit XIX, shqiptarët si dhe të huajt me termin Shqipëri (Albania, Arnautluk) kishin parasysh territorin gjeografik-politik që përfshihej tërësisht në sanxhaqet e Shkodrës, Dukagjinit (Pejë), Prizrenit, Vuçiternit (Prishtinës), Ohrit, Elbasanit, Vlorës, Delvinës dhe Janinës, si dhe një pjesë të territorit të sanxhaqeve të Shkupit e të Manastirit. Kjo Shqipëri kufizohej nga veriu me Dalmacinë Venedike, pjesa jugore e së cilës quhej «Shqipëria Venedike», dhe me Bosnjën e Serbinë, nga lindja me Maqedoninë e Thesalinë, nga jugu me Greqinë (të gjitha këto provinca të Perandorisë Osmane), dhe nga perëndimi me detin Adriatik e atë Jon. Bregdeti shqiptar fillonte nga krahina e Tivarit dhe përfundonte në jug në Gjirin Ambrakik¹.

Duke u nisur nga fakti se në kufijtë e kësaj Shqipërie përfshihej jo vetëm pjesa kryesore e hapësirës shqiptare, por edhe disa krahina joshqiptare, koncepti «Shqipëri» kishte karakter etnik-politik. Ky koncept përfshinte pjesën më të madhe të trojeve ku ishte formuar populli shqiptar dhe ku ai dallohej për nga zotërimet tokësore, gjuha e

1) St. N. Naçi. *Rreth konceptit «Shqipëri» në gjysmën e dytë të shek. XVIII*, në «Studime historike», Tiranë, 1976, nr. 2, f. 60-65.

zakonet e veta si kombësi e veçantë, e ndryshme nga kombësitë sllave e greke me të cilat ishte fqinjë apo nga pakicat e këtyre kombësive me të cilat bashkëjetonte në kufijtë administrativë-politikë të lartpërmendur².

Në dëshmitë e literaturës dhe të dokumentacionit bashkëkohor, Shqipëria ndahet në dy pjesë: në Shqipërinë e Poshtme ose Jugore, të quajtur nga pikëpamja etnografike *Toskëri* dhe në Shqipërinë e Sipërme ose Veriore, të quajtur edhe *Gegëri*. Prandaj shpesh bashkëkohësit flisnin për dy Shqipëri, nga të cilat ajo Jugorja përfshinte territoret e sanxhaqeve të Vlorës, Delvinës e Janinës dhe krahinat e Kosturit, Bilishtit. Korçës e Kolonjës të sanxhakut të Manastirit; kurse Shqipëria Veriore përfshinte territoret e sanxhaqeve të Shkodrës, Dukagjinit, Prizrenit, Vuçiternit, Ohrit e Elbasanit, si dhe krahinat e Kumanovës dhe Kaçanikut të sanxhakut të Shkupit.³

*
* *
*

Trualli i Shqipërisë Veriore të gjysmës së dytë të shekullit XVIII — 30 vitet e para të shekullit XIX ishte sikurse edhe sot, një vend kryesisht malor. Të tilla ishin edhe trojet e Dalmacisë dhe të Bosnjës, por, ndryshe nga këto vise fqinje, vargmalet shqiptare nuk ishin të thata, përkundrazi, ato ishin në përgjithësi të mbuluara me pyje e kullota, kurse fushat, luginat e rrafshinat ishin pjellore, përkohëshin nga lumenj dhe ishin të përshtatshme për rritjen e mjaft kulturave bujqësore. Veçse, sipas vërejtjeve të disa dëshmitarëve të huaj, që patën mundësi dhe detyrë të përshkonin pjesën më të madhe të vendit, jo e gjithë toka e punueshme mbillej e korrej. Toka të papunuara kishte veçanërisht nëpër zonat malore, por kishte edhe në zonat fushore. Sipas përshtypjeve të tyre del se vargmalet e Shqipërisë Veriore ishin më të pasura në pyje e kullota se ato të Shqipërisë Jugore, dhe se edhe fushat, luginat e rrafshinat e Gegërisë ishin të punuara më mirë nga ato të Toskërisë.⁴

Vargmalet që ngriheshin në të dy anët e lumit Drin, pohonte me 1807 koloneli i ushtrisë franceze Gjijomë dë Vondonkur, si dhe malet kundrejt detit Adriatik që mbërrinin deri në afërsitë e Durrësit, ishin të mbuluara me pyje të dendura dhe me drurë shumë të mirë për ndërtime. Kurse rrafshina e Prizrenit, fusha nga bregu i liqenit të Shkodrës deri në Podgoricë, fusha e Shkodrës, brigjet e lumit Drin nga Plava në Zadrimë, dhe sidomos fusha bregdetare nga Lezha në Shkumbin ishin të punuara shumë mirë. Ato, theksonte koloneli në fjalë, ishin «jashtëzakonisht pjellore veçanërisht për verë, grurë dhe kullota». Edhe

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Odile Daniel — *Choix de documents historiques et géographiques conservant l'Albanie*, Paris Nanterre 1967-1968, f. 14-15, 93-94. Pouqueville. Fr. *Voyage en Grèce*. vol. III, f. 68.